

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mijëra hektarë të djegur, BIRN: Sezoni i zjarreve nxjerr në pah dobësitë sistemike të shtetit
ADRESA	https://albeu.com/lajme/mijera-hektare-te-djegur-birn-sezoni-i-zjarreve-nxjerr-ne-pah-dobesite-sistemike-te-shtetit/1005175/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 06:52:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 06:49:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f2f1f0b952c04d85f367ca18356ce3f1df117938831e0766c58e25ca9fa8f75e
TEKSTI	4fb2f37a5f615be2c7473c3e9bd914643bc6841be49361abf7b80034657f1beb
PAMJA	17b5e856ce46e5322020a5105985aa6e679b41826fba366fb8e30d2a0fd50bc0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72ee48efccdde9d20b88a79eafb3dd092a0153265d69179d47ca79fde8497bf1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37e88de21e6052c43008725ce34c5b1787df35e11e0ce0b49f71d19634f38dd3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72ee48efccdde9d20b88a79eafb3dd092a0153265d69179d47ca79fde8497bf1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mijëra hektarë të djegur, BIRN: Sezoni i zjarreve nxjerr në pah dobësitë sistematike të shtetit



Shqipëria e ka identifikuar prej vitesh rritjen e rrezikut nga zjarret për shkak të ndryshimeve klimatike, por ekspertët ngrenë pikëpyetje mbi masat për parandalimin dhe menaxhimin e tyre si dhe dobësitë e bashkëpunimit institucional.

Në fillim të shtatorit, qyteti bregdetar i Himarës u rrethua nga flakët që po digjin ullinj të kodrat e zonës së Potamit.

Turistë dhe banorë u evakuuan me urgjencë, ndërsa tymi pushtoi qytetin.

Një bilanc paraprak i autoriteteve vendore, flet për dhjetëra rrënjë ullinjsh shekullorë të djegur si dhe disa shtëpi të shkrumbuara plotësisht.

Vatra të tjera zjarresh u shfaqën në fillim të këtij muaji në disa zona të vendit, kryesisht në kullota dhe pyje, ndërsa shifrat zyrtare flasin për mijëra hektarë tokë të prekur nga zjarret gjatë verës.

Vetëm gjatë muajve korrik-gusht, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) ka evidentuar 5,210.4 hektarë tokë të prekur nga zjarret në të gjithë vendin.

Sipas të dhënave të ofruara për BIRN, sipërfaqja më e madhe është regjistruar në qarkun Shkodër me 2,416 hektarë, e ndjekur nga Lezha me 1,278 hektarë, Dibra me 642.4 hektarë dhe Tirana me 631 hektarë.

Në qarqet Durrës, Fier dhe Elbasan janë evidentuar respektivisht 105, 97 dhe 41 hektarë të prekur.

Megjithatë, kjo sipërfaqe nuk përbën bilancin përfundimtar të zjarreve në rang vendi.

ASIG sqaron se kjo shifër i referohet vetëm 14 zonave të matura me kërkesë të Agjencisë Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ndërsa procesi i matjes po vijon edhe për zona të tjera që janë prekur nga zjarret.

të fundit /



LAMM bën me dije: Në pikat kufitare nuk regjistrohen radhë të...



Oftë 100 milionë euro nga Chelsea për talentin turk të Real...



Azilet shqiptare synojnë staf nga Filipinet dhe Tunizia përballë krizë...



Shala apo Bajrami? – Dy skenarë për drejtimin e LDK-së,...



Mbyllet sot xhiro e parë e Champions League 2026/27 me gjashtë...



Konflikti SHBA-Iran, parashikimi i Trump: zgjidhja pas zgjedhje...



Haradinaj shpreh bindjen për kthimin e katër ish-krerëve të...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Në një matje të pavarur përmes një metodologjie të ngjashme, eksperti hapësinor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë, FAO, Flavio Vata zbuloi mbi 6200 hektarë tokë të djegur deri më 18 gusht.

Diferenca nuk do të thotë domosdoshmërisht se njëra matje është e gabuar dhe se rezultatet mund të ndryshojnë në varësi të imazheve satelitore, periudhës së analizuar, sipërfaqes minimale të zjarrit dhe kategorive të tokës që përfshihen në llogaritje.

Por e rëndësishme, sipas Vatës, është që shifrat të trajtohen nga institucionet *“si një sinjal serioz për mënyrën se si menaxhojmë pyjet dhe territorin”*.

Edhe ekspertja e mjedisit, Ornela Çuçi, paralajmëron se përmasat e zjarreve nuk duhen lexuar vetëm përmes një shifre të vetme, por si një risk i përsëritur që kërkon marrjen e masave për parandalimin e tyre.

“Sinjali i alarmit nuk është vetëm numri 5,200. Është fakti që kemi një risk të përsëritur, me variabilitet të madh dhe me potencial për sezone ekstreme,” tha Çuçi.

Për ekspertin e mjedisit, Mihallaq Qirjo, vrojtimi mbi rastisjen dhe shkallën e përhapjes së zjarreve na dëshmon se ata janë intensifikuar gjysmën e dytë të muajit gusht.

“Është shtuar thatësira e tokës dhe temperatura e saj është rritur, pra kushte favorizuese për shkaktim dhe përhapje zjarresh dhe me gjithë përqendësimin e situatës, ka zjarrvënje të reja,” konstatoi Qirjo.

Të papërgatitur për ndryshimet klimatike



Qeveria shqiptare e ka identifikuar rritjen e rrezikut nga zjarret si pasojë të pritshme të ndryshimeve klimatike në disa dokumente zyrtare.

Në Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030, theksohet fakti që modelet klimatike parashikojnë temperatura më të larta, periudha më të gjata thatësire dhe më pak reshje, veçanërisht gjatë verës, duke rritur frekuencën dhe ashpërsinë e zjarreve dhe duke zgjatur sezonin e tyre.

Në dokumente të tjerë për ndryshimet klimatike dhe planet kombëtare të përshtatjes ndaj tyre janë parashikuar masa që lidhen me parandalimin, monitorimin, paralajmërimin e hershëm, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe menaxhimin e riskut.

Edhe ekspertët vlerësojnë se ndryshimet klimatike janë një faktor i rëndësishëm në shkaktimin e zjarreve ose në përhapjen e lartë të tyre edhe kur ato shkaktohen nga njeriu.

Megjithatë, ata konsiderojnë se institucionet kanë dështuar në marrjen e masave për parandalimin dhe menaxhimin e situatës.

Bazuar në analizat e tij si ekspert, Vata thotë se rritja e temperaturave, thatësira dhe deficit i lagështisë po krijojnë kushte më të favorshme për zjarret ekstreme.

“Po hyjmë në një periudhë ku anomalitë ekstreme mund të bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për menaxhimin e rrezikut,” thotë ai.

Ai vë në pikpyetje aftësinë e vendit për të përdorur kapacitetet që ka në dispozicion, siç janë teknologjitë satelitore dhe aksesin në sistemet europiane Copernicus/EFFIS, në integrimin e një sistemi të vetëm operacional që të lidhë parandalimin, monitorimin, paralajmërimin e hershëm, reagimin dhe rehabilitimin pas zjarrit.

Në këtë kuptim, shton Vata, *“mendoj se objektivi nuk duhet të jetë thjesht të dimë sa hektarë janë djegur pasi sezoni ka përfunduar, por të dimë sa më shpejt se ku po fillon një zjarr, sa shpejt po përhapet, çfarë po prek, kush është i ekspozuar dhe ku duhet të ndërhyhet”*.

Ai vë në dukje se dobësitë kryesore lidhen me nevojën për një qasje më të integruar ndaj zjarreve: parandalimin e rrezikut përmes identifikimit të zonave me risk të lartë dhe menaxhimit të vegjetacionit, monitorimin në kohë reale përmes integritetit të të dhënave satelitore optike dhe termike, ngritjen e sistemeve të hershme të paralajmërimit dhe lidhjen e informacionit satelitor me strukturat që marrin vendime dhe ndërhyjnë në terren.

Ornela Çuçi e vendos të njëjtin problem në planin e funksionimit institucional.

Shprehësitë, siç është ajo, nuk i mungojnë institucionet për lidhje me tre si një sistem i vetëm i menaxhimit të rrezikut

Shqipëria, sipas saj, nuk i mungojnë institucionet, por mungon një sistem i vetëm i menaxhimit të rrisht.

"Nëse institucionet tona takohen për herë të parë të flaka, atëherë janë takuar shumë vonë".
thotë Çuçi.

Ajo argumenton se se menaxhimi i një zjarri pyjor nuk duhet të nisë me mobilizimin e zjarrfikësve, bashkive, Mbrojtjes Civile apo Forcave të Armatosura pasi shfaqet zjarri, por nis me identifikimin e zonave me risk të lartë, gjendjen e vëgjetacionit, materialin potencialisht të djegshëm, rrugët e aksesit dhe masat parandaluese.

Sipas saj, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe strukturat pyjore të qeverisjes vendore duhet të ndërhyjnë përpara emergjencës, ndërsa informacioni satelitor dhe strukturat e mbrojtjes civile duhet të lidhen me vendimarrjen dhe ndërhyrjen në terren.

"Problemi është se institucionet që kemi ende nuk funksionojnë sa duhet si një sistem i vetëm i menaxhimit të riskut", shton ajo.

Nga ana tjetër, Mihallaq Qirjo flet për nevojën e masave konkrete në terren, nga krijimi i infrastrukturës mbrojtëse dhe pozicionimi paraprak i mjeteve pranë zonave me rrezik, deri te përfshirja e komuniteteve në parandalim dhe menaxhimi i sipërfaqeve të djegura.

"Ndërgjegjësimi i komuniteteve, specifikisht i popullsisë fshatare që banojnë pranë pyjeve është i dobët, i paorganizuar, jociësor. Infrastruktura mbrojtëse e pyjeve prej zjarreve kërkon përmirësim, mjetet mbrojtëse të stacionohen në pyje, të krijohen rezervuarë uji në pyje", thotë ai.

Qirjo evidenton gjithashtu mungesën e një dokumenti teknik për trajtimin e sipërfaqeve pyjore të djegura, që sipas tij duhet të bazohet në rigjallërimin e vetë natyrës në vitet e para dhe më pas të ndihmohet procesi me ndërhyrje që imitojnë natyrën./ BIRN

Shtuar më 10.09.2026 08:49

Tags: BIRN , demet , zjarret



Rritja e çmimit të karburanteve ka gërryer të ardhurat e përdoruesve/...



Qytetarët 103 ditë protestë, vijon aksioni kundër qeverisë: Rama jep...



Parashikimi i motit 10 Shtator 2026/ Kthjellime dhe vranësira, ja si do të...



Pas fjalimeve, protestuesit kalojnë në marshim dhe bllokojnë akset kryesore t...



Bardhi kërkon heqjen e imunitetit të Ballukut: Sa vila të padëklaruar duhe...



A pritet një kërkesë e re për arrestimin e Ballukut? Klodiana Lala zbulon det...



Zbardhet plagosja e dy miqve në Laprakë, identifikohet dhe shpallet...



Ahmetaj akuza të forta: Thonë që Ramën s'e kanë kapur me para, edhe El...

albeu

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argëtim

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.